

Bazuar në nenin 16 paragrafin (4) të Ligjit për Arsimin Profesional dhe Trajnim (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” Nr. 3/25 dhe 74/25), Ministri i Arsimit dhe Shkencës solli

RREGULLORE

PËR PËRMBAJTJEN DHE FORMËN E DEKLARATËS PËR SERIOZITETIN NGA PUNËDHËNËSI DHE UDHËZIME PËR PLOTËSIMIN E SAJ.

Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohet përmbajtja dhe forma e Deklaratës së Seriozitetit nga punëdhënësi dhe udhëzimet për plotësimin e saj.

Neni 2

Deklarata nga neni 1 i kësaj rregulloreje, plotësohet në formularin me përmasa A4, përmbajtja e të cilit është dhënë në Shtojcë, pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

Neni 3

Kjo rregullore hyn në fuqi të nesërmen nga dita e sjelljes së saj.

Nr.

18. 11124/

Data

1.1.08.2025

Shkup



Министер за образование и наука,

проф. д-р Весна Јаневска

DEKLARATË PËR SERIOZITETIN NGA PUNËDHËNËSI

Unë, i nënshkruar mëposhtë, si person i autorizuar i subjektit juridik
1. _____, me selinë në adresë 2. _____, me NVAS
3. _____ dhe NVT numri 4. _____, deklaroj:

- Se do të jem i përkushtuar për të marrë pjesë në arsimin dual duke përgatitur kuadrin për kualifikimin/programin
- 5. _____, nga sektori 6. _____.
- Se do të siguroj mjedis adekuate të punës dhe mbështetje mentoruese për 7. _____ nxënës, të cilët do të marrin pjesë në programin e arsimit dual.
- Detyrat dhe aktivitetet e punës të cilat do t'u caktohen nxënësve do të jenë në përputhje me programin mësimor të tyre për mësim përmes punës dhe praktikës feriale
- Se është siguruar së paku një mentor i cili do të jetë përgjegjës për realizimin e mësimin praktik.
- Do të caktohen detyra dhe do të ndjeket përparimi dhe suksesi i nxënësve, përmes monitorimit dhe vlerësimit të punës së nxënësve dhe do t'i jepet reagime nxënësit, mësimdhënësit/shkollës dhe nëse është e nevojshme, prindit.
- Se janë siguruar mjete financiare për pagesën mujore të nxënësve në përputhje me Ligjin për Arsimin Profesional dhe Trajnim.
- Se janë siguruar kushte për sigurinë dhe shëndetin gjatë punës së nxënësve në mjedisin e punës, në përputhje me standardet e nënshkruara.

Personi kontaktues -----, numri i telefonit -----.

(Nënshkrimi i personit të autorizuar)

Data dhe vendi

Udhëzime për plotësimin e Deklaratës për Seriozitet nga punëdhënësi

Pika 1. Shënohet emri i punëdhënësit/kompanisë.

Pika 2. Shënohet adresa ku ndodhet selia e punëdhënësit/kompanisë.

Pika 3. Shënohet Numri Amë i identifikimit të subjektit - punëdhënësit/kompanisë.

Pika 4. Shënohet Numri unik tatimor i punëdhënësit/kompanisë.

Pika 5. Shënohet titullin e kualifikimit.

Pika 6. Shënohet emri i sektorit të cilit i përket kualifikimi.

Pika 7. Shënohet numri i përgjithshëm i nxënësve që mund të pranohen për arsim praktik tek punëdhënësi/kompania.